



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT SHKODER

264/1
Nr. prot.

Shkodër, më 26.04.2022



LËNDA: Mbi vendimin Nr. 23, datë 21.04. 2022 të Këshillit të Bashkisë Vau-Dejës.

KESHILLIT BASHKIAK VAU-DEJES

Prefekti i Qarkut Shkodër në zbatim të kompetencave që i jep ligji nr.107/2016 dt.2.10.2016 “Për Prefektin”, Urdhërit të Kryeministrit Nr.50, datë 12.04.2017 “Për miratimin e detyrave të administratës së Prefektit të Qarkut”, Urdhërit të Ministrit të Brendshëm Nr.175 dt.9.07.2020 “Për miratimin e rregullores së Brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut”si dhe aneksi 1 “Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollit nga Prefekti i Qarkut”, Kreu II, neni 4, analizoi **VKB Vau-Dejës nr.23 datë 21.04.2022 “Mbi miratimin e akteve të themelimit të shoqërisë tregtare, në pronësi të Bashkisë Vau-Dejës, në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar** sipas materialit të dërguar nga sekretari i këshillit bashkiak Vau-Dejës mbi mbledhjen e këshillit bashkiak Vau-Dejës të datës 21.04.2022”.

Prefekti i Qarkut Shkodër në zbatim të kompetencave që i jep ligji nr.107/2016 dt.2.10.2016 “Për Prefektin”, Ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, neni 9 pika 1.6/b, neni 28, neni 54/d, neni 55/3, neni 64/c, ligjit Nr.9723/2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit ” i ndryshuar ju lejon procedim të mëtejshëm.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

P R E F E K T I

Majlinda ANGONI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VAU DEJES
KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr 23, Date 21.04.2022
PËR

“PËR KRIJIMIN E SHOQËRISË “ ZADRIMA AGRIKULTURE ” SHPK, SI PERSON JURIDIK NË PRONËSI TË BASHKISË VAU DEJËS DHE MIRATIMIN E AKTEVE TË THEMELIMIT”

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, neni 9, pika 1.1/b, pika 1.6/b, neni 27, pika 4, neni 54/d, neni 55 pika 3 e Ligjit Nr 139/2015 “ Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; Dispozitat mbi Shoqëritë me Përgjegjësi të Kufizuar të Ligjit nr 9901, dt 14.04.2008 “ Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”i ndryshuar; neni 30 i Ligjit Nr 9817 datë 22.10.2007 “ Për bujqësinë dhe zhvillimin rural” ; pika 2.3, gërma a) e VKM-së nr 101 date 09.02.2022 “ Për përcaktimin e kritereve bazë të sektoreve që do të mbështeten dhe të masës së financimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, për vitin 2022”, i ndryshuar, Keshilli i Bashkisë Vau Dejës;

VENDOSI

1. Të miratojë aktet e themelimit dhe krijimin e shoqërisë me emërtimin tregtar “ Zadrime Agrikulture”sh.p.k shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e zotëruar në masën 100 (njëqind) % të kapitalit të shoqërisë nga Bashkia Vau Dejës, me objekt veprimtarie :Menaxhimi i tregjeve të produkteve bujqësore, grumbullimi dhe ruajtja e produkteve bujqësore të agrikulturës, agropërpunimit . Të ngarkojë kryetarin e Bashkisë, që të nënshkruaje aktet e themelimit të kësaj shoqërie tregtare.
2. Kapitali fillestar për krijimin e shoqërisë “ Zadrime Agrikulture” shpk, të jetë 100 (njëqind)lekë.
3. Shoqëria“ Zadrime Agrikulture” shpk, të ketë seline qendrore në adresën , pranë zyrave të Bashkisë Vau Dejës, Rruga Qafa e Gurit, Ndërtesa nr 9 , hyrja nr 1 , Lac Fshat , zk 8598,Vau Dejës.
4. Shoqëria “ Zadrime Agrikulture” shpk, të zhvillojë aktivitetin e saj për një afat të pacaktuar.
5. Efektet financiare për zbatim e këtij vendimi, për krijimin e kapitalit fillestar të shoqërisë, në vlerën 100(njëqind)lekë, përballohen nga buxheti i vitit 2022, dhe bashkia Vau Dejës transferon këtë shumë pranë kësaj shoqërie menjëherë pas regjistrimit të saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
6. Bashkia Vau Dejës, brenda 15(pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, ndjek procedurat e nevojshme për regjistrimin e shoqërisë “ Zadrime Agrikulture” shpk, në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

7. Shoqëria “ Zadrime Agrikulture” shpk, ka në funksion të ushtrimit të veprimtarisë së saj, ka të drejtë të shqyrtojë dhe të vlerësojë mundësinë e bashkëpunimit me shoqëri të tjera tregtare dhe të hyjë në marrëdhënie kontraktuale me persona të tretë.
8. Të autorizojë kryetarin e Bashkisë, që të përfaqësojë Bashkinë Vau Dejës, në cilësinë e ortakut të vetëm për kryerjen e të gjitha veprimeve të nevojshme për përgatitjen dhe nënshkrimin e akteve të themelimit të shoqërisë së re dhe regjistrimin e saj sipas legjislacionit në fuqi.
9. Bashkia Vau Dejës i siguron shoqërisë “ Zadrime Agrikulture” shpk, nga inventari i saj i pronave të paluajtshme , mjediset e nevojshme për regjistrimin e saj sipas legjislacionit në fuqi.
10. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë , Drejtoria Juridike e Prokurimeve dhe Integritetit për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.
11. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6 të Ligjit nr 139/2015 “ Për vetëqeverisjen vendore” .

Ky vendim u shpall sot me date 22. 04.2022

**KRYETAR
Mark BISHA**

**Sekretar i Këshillit Bashkiak
Ardian Çelepija**



Miratuar me 17 vota

Vota Pro 17

Vota Kunder -

Vota Abstenim -

Zbardhur me date 22.04.2022